



Datë: 07.07.2025

Numër Protokolli: 4783/2025

A.nr.804/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.804/2025, të datës 05.05.2025, të parashtruar nga ankuesi G.H, kundër organit të punësimit: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.804/2025, të datës 05.05.2025, të parashtruar nga ankuesi G.H.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, G.H (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi*), më datë 05.05.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2943/2025, të regjistruar nën shenjë A.nr.804/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016977, për pozitën e punës së *Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve*, të shpallur sipas konkursit të datës 07.03.2025, nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 21.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa kjo e fundit më datë 22.05.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.804/2025, sepse:

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i provave të lëndës, ka gjetur se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me datë 07.03.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00016977, për Grupin Arkiv-Dokumentacionit, gjegjësisht pozitën e punës *Zyrtar për Administrimin e*

Dokumenteve, në Zyrën Lokale të Pensioneve në Mitrocië, me afat aplikimi nga data 08.03.2025 deri më datë 06.04.2025.

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë katër dhjetë e shtatë (47) kandidatë, ku prej tyre dhjetë (10) kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, ndërsa sipas Njoftimit të 18.04.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në organin përkatës të punësimit, rezulton se ankuesit i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk plotëson kriterin arsimor për të vazhduar tutje.

Tutje, sipas Njoftimit të datës 02.05.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, rezulton se kandidati R.P, me gjithsejtë 92.4 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, është shpallur kandidat fitues për pozitën Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve.

Ankuesi, ankesën e ka parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se plotëson kërkesat e përgjithshme formale, ngase me shpalljen e konkursit përkatës nuk janë përcaktuar fusha të caktura të studimeve, andaj kërkon përfshihren e tij në listën e ngushtë, rrjedhimisht vazhdimin tutje në procedurat e vlerësimit.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati Arif Kadriu, si kandidat aplikues në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016511, për pozitën e punës *Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve*, në Zyrën Lokale të Pensioneve në Mitrocië, kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër procedurës së njëjtë të rekrutimit, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.709/2025, të datës 20.06.2025, ka anuluar në tërësi këtë procedurë rekrutimi.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.804/2025, të datës 05.05.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.709/2025, të datës 20.06.2025, rrjedhimisht ka anuluar procedurën e pranimit sipas konkursit me numër reference RN00016511, atëherë mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*. Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr. 804/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.804/2025, të datës 05.05.2025.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.804/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit G.H;
- Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.